

TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E MEDVEGJËS VESHJA E BURRAVE SHQIPTARË TË MEDVEGJËS

Prof.Mr.Sc. Rexhep ABAZI
Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Komuna e Medvegjës ka një histori të veçantë, mbase edhe të dhimbëshme, brenda këtyre 144 viteve prej kurë mbeti e vetmuar, brenda kufinjëve të Serbisë, atëbotë të lashtë kur Serbia bëri spastrimin etnik të popullatës shqiptare nga Sanxhaku i Nishit, Leskocit, Kurshumlisë, Prokupjes, Leskocit, Vrajës e t.j. duke i dëbuar shqipëtarët, sipas studiuesit prof. Dr. Sabit Ukës, nga 740 vendbanime shqiptare.

Fjalë kyçe: veshje, trashëgimi kulturore, pasivizim, komune, opinga, jelek

ABSTRACT

The municipality of Medvedja has a special history, perhaps even painful, within these 144 years since it was left alone, within the borders of Serbia, then ancient when Serbia carried out ethnic cleansing of the Albanian population from Sandzak of Nis, Leskovac, Kursumlija, Prokuplje, Leskovac, Vraja, etc. expelling the Albanians, according to the researcher prof. Dr. Sabit Ukës, from 740 Albanian settlements.

Key words: clothes, cultural heritage, passivity, municipality, opingas, vest

HYRJE

Komuna e Medvegjës ka një histori të veçantë, mbase edhe të dhimbëshme, brenda këtyre 144 viteve prej kurë mbeti e vetmuar, brenda kufinjëve të Serbisë, atëbotë të lashtë kur Serbia bëri spastrimin etnik të popullatës shqiptare nga Sanxhaku i Nishit, Leskocit, Kurshumlisë, Prokupjes, Leskocit, Vrajës e t.j. duke i dëbuar shqipëtarët, sipas studiuesit prof. Dr. Sabit Ukës, nga 740 vendbanime shqiptare. Që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, në Medvegjë mbetën të jetonin shqiptarët vetëm në dymbëdhjetë vendbanime: Sfirçë, Starabajë, Gërbac, Ramabajë, Siarinë, Bajë e Siarinës, Tupallë, Kapit, Gjylekarë, Dediq, Llapashticë, Medvegjë. Në 30 vendbanimet e tjera të kësaj komune, të cilat deri atëherë ishin vetëm me banorë shqiptarë, u sollën kolonistë serbë e malazez dhe aty jetojnë edhe sot e kësaj dite. Pse ndodhi kjo me shqiptarët e këtyre trojeve, të cilët u shpërndanë në të katër anët e botës as nuk dha kush përgjigje, as nuk pati përgjegjësi ligjore e morale, për ata që e shkaktuan këtë golgotë të poullatës shqiptare. Rruga e të dëbuarëve ishte e rëndë dhe e larë me djesrë e me gjak, madje edhe me gjakun e fëmijëve dhe foshnjeve në djep. Sepse koha në të cilën ata u dëbuan nga trojet dhe shtëpitë e tyre ishte dimri i viteve 1877/1878, i mbajtur mend për nga acari dhe të ftohtit i cili i ngrinte njerëzit që i nxinte nata në rrugë. Por, sido që të jetë, besoj se një ditë, me këto gjëra do të merret historia dhe historianët, e që besa edhe drejtësia, sepse këto krime ndaj njerëzimit nuk falenë e mendoj unë, se as nuk vjetohen kurrë. Pavarësisht situatës së rëndë në të cilën u gjetën shqiptarët e trojeve të Medvegjës, sepse disa nga vendbanimet e tyre edhe u ndanë në dysh, siç është rasti me fshatin Sfirçë dhe Tërstenë, të cilët me kufirin e rinj të Turqisë dhe Serbisë mbetën të ndara në dy komuna, përkatësisht në dy shtete (Turqi e Serbi), e sot në Kosovë e Serbi. Sa e rëndë ishte ajo ndarje e dinë vetëm ata që e përjetuan, por kjo brengë i përcolli e po i përcejell edhe pasardhësit e njerëzve të këtyre trevave deri në ditët e sotme, e fatkeqësisht e padyshim që do jetë brengë edhe tek gjeneratat e ardhme. Sido që të jetë, jeta e këtyre shqiptarëve vazhdoi të rrjedhë disi e me vështirësi të përhershme qoftë nga kushtet e rënda, qoftë nga padrejtësitë e bëra nga shteti i Serbisë, në të

gjitha regjimet e deritanishme. Nuk munguan torturat, maltretimet, shantazhimet, plaçkitjet, rrahjet madje edhe vrasjet e shqiptarëve të pafajshëm e të pambrojtur nga askush.

U vra e u zhduk pa gjurmë Malë Murati nga Sfirca, u vranë në prag të shtëpisë tre burra dhe një vajzë, të familjes Osmani nga Llapashtica e Epërme, u vra e masakrua Tahr Zejnullahu nga Svirca nga çetnikët e Siarinës së bashku me axhutantit e tij, u vra në shtëpinë e vet Ajet Rama në shtëpinë e vet në ditën e Bajramit, gjaku i të cilit e fiku vatrën e zjarrit në oxhak, u morën në natën e festës së Kurban Bajramit 33 burra nga shtëpitë e tyre në fshatin Svirçë e afro dhjetë të tjerë nga fshati Gërbac, me 18 nëntor të vitit 1944 e u tretën pa gjurmë pa u ditur kurrë se çfarë ndodhi me ta. As kohërat e fundit nuk kaluan pa viktima të shqiptarëve të Medvegjës. Pa gjurmë u zhduk i riu shqiptar i fshatit Gërbac, Qamil Sylja, në verën e vitit 1999, e për rrahjet, burgosjet e shantazhimet nga forcat policore, militare e paramilitare serbe duhet letër e madhe për t'i përfshirë të gjitha.

PASIVIZIMI I ADRESAVE TË SHQIPTARËVE TË MEDVEGJES SI MASË E SPATRIMIT ETNIK

Nuk ishte e mjaftueshme e gjithë ajo që iu bë shqiptarëve, ndaj Serbia tani e ca vite në Preshevë, Medvegje e Bujanoc, po ndërmerr masa administrative të ashtuquajtura PASIVIZIM TË ADRESAVE të banorëve shqiptarë, me çka ata mbesin pa vendbanim, pa të drejtë vote, pa të drejtë mundësie të zgjedhin e të zgjidhen, pa të drejtë në dokumenti të identifikimit, pa të drejtë në dokumente të udhëtimit, pa të drejtë të blejnë apo të shesin pasuri të patundëshme, pa të drejtë të regjistrimit të automjetit, pa të drejtë në sigurim shëndetësor, pa të drejtë pune, pa të drejtë shkollimi etj. Për momentin këta njerëz janë “AS NË TOKË, AS NË QIELL”.

Duhet cekur këtu edhe presionin e viteve 1999/2000 në këto treve i cili shkakëtoi dëbimin e një numri të konsideruar të shqiptarëve të cilët kurrë nuk e gëzuan statusin e refugjatëve e që tani ajo po u kushton edhe me pasivizimin e adresave. Të gjitha këto së bashku, në ditët e sotme kur shoqëria njerëzore ka arrijtur shkallën më të lartë të zhvillimit të saj, shqiptarët e Luginës së Preshevës po përballen me primitivizmin më të rëndë të shkaktuar nga shteti i Serbisë, të cilës i paguajnë të gjitha detyritmet si qytetar rezident të saj. Në qoftë se nuk ndërmerren masa të duhura të cilat shtetin e Serbisë do ta detyronin të respektoj Kartën e të Drejtave dhe Lirive të njeriut, ligjet elementare për pakicat, ligjet për refugjatët, ky spastrim i tentuar, e besa edhe i realizua nga Serbia do shkaktoj pasoja vështirë apo edhe të pa riparueshme për popullatën shqiptare. Mbase, në këto kushte e rrethana është e rrezikuar vet qenja njerëzore shqiptare, e vështirë të mund të mendohet për të tjera gjëra.

Por sido që të jetë, edhe në këto kushte ekstreme të vështira, popullata shqiptare, me sakrificë e mundime titanike, deri më tani rrezistoi të mos asimilohet e të mos zhbëhet nga këto troje, me ç'rast ruajti vlerat më sublimë kombëtare: historinë, gjuhën, kulturën, adetet e zakonet, këngën, folklorin, dasmën, veshjen autoktone kombëtare të grave e të burrave, zakonet mortore, një lloj zejtarie e tregëtie, kultivimin e pemëve e perimeve, blektorinë e bujqësinë e të tjera. Ruajti e zhvilloi një trashigimi kulturore me një dashuri të skajshme, me një vullnet vullkanik e me një gjelozë të rrallë. Mirëpo, tani në kohët e fundit kjo po çbehet e kam frikë se edhe do të humbasi në qoftë se nuk ndërmirret diçka në këtë aspekt. Kësaj radhe do të përqëndrohemi në shkrimin për VESHJEN KOMBËTARE TË BURRAVE NË KOMUNËN E MEDVEGJËS, si pjesë e rënësishme e trashigimisë kulturore kombëtare.

VESHJA KOMBËTARE E BURRAVE SHQIPTARË NË KOMUNËN E MEDVEGJËS



Siç e ceka edhe më lartë treva shqiptare e Medvegjës ruajti dhe aq sa ishte në mundësinë e sajë edhe e zhvilloi një trashigimi kulturore në kushte e rrethana ekstremisht të vështira. Kjo trashigimi përveq globalitetit kombëtar si bazë e zhvillimit të trashigimisë kulturore, i pati e i ka edhe specifkat e veta të kësaj kulture. Këtu mund të themi se gjatë një periudhe të gjatë kohore, kur ishte edhe shumë e ndarë nga trangu dhe pjesët e tjera të trojeve kombëtare shqiptare, Medvegja dhe shqiptarët e sajë ruajtën dhe zhvilluan një trashigimi kulturore për ca nuanca të veçantë nga pjesët e tjera, por gjithmonë e në çdo kohë plotësisht shqiptare. Duhet veçuar Veshjen e grave dhe të burrave shqiptarë në komunën e Medvegjës. Për veshjen e grave në komunën e Medvegjës kam bërë një ekspozë

dhe e kam paraqitur në seancën e Kësaj Akademije, të dytën me rradhë të mbajtur në Tiranë, e kësaj here do bëj një vështrim të Veshjes kombëtare të burrave shqiptarë në Komunën e Medvegjës. Që në fillim duhet cekur se bëhet fjalë për një veshje kombëtare e cila tani më është vetëm si pjesë e muzeve, si trashigimi e entuziastëve e cila ruhet në familje, të themi si uniformë, e grupeve, ansambleve e shoqërive kulturo artistike për paraqitje në skenë në programe të ndryshme etj. Dikurë kjo ishte veshje e ditëpërditshme e shqiptarëve në punë, në arë, në livadh, në dasëm e në rrugë, kështu që nga largësia dallohej shqiptari me veshjen e tij, kuptohet siç dalloheshin edhe të tjerët me veshjet e tyre. Kjo veshje tek shqiptarët e Medvegjës, në kuptimin e fjalës u mbajtë në trup afërsisht deri në luftën e II-të Botërore. Me përfundimin e kësaj lufte, vendi pësoi të themi ndryshime radikale, madje edhe në veshjen e njerëzve. Veshjet kombëtare filluan dalngadal të zëvendësoheshin me veshje të ashtuquajtura “allafranga”, prandaj veshja kombëtare edhe tek shqiptarët filloi të zëvendësohet me këto veshje të huaja. Edhe ata burra që i bartnin veshjet kombëtare filluan të rralloheshin e dita më ditë edhe të pakoheshin. Mund të them se tani në trevat e Medvegjes nuk shohim njeri që për çdo ditë vishet me veshje kombëtare, ndoshta që nga vitet e shtatëdhjeta-tetëdhjeta. Disa nga njerëzit që unë mbajë mend me veshje kombëtare të burrave të Medvegjës janë:

1. Imer (Abaz) Abazi, Sfirçë;
2. Qerim (Hatem) Abazi, Sfirçë;
3. Ali (Aziz) Zeqiri, Sfirçë;
4. Lam (Shaban) Baftiu, Sfirçë;
5. Zukë (Hysen) Demiri, Sfirçë;
6. Rexhë (Zmajl) Ismajli, Gërbac;
7. Ali (Naman) Ismajli, Tupallë;
8. Kadri (Naman) Ismajli Tupallë;
9. Salih (Shahin) Emini, Tupallë,
10. Mustafë (Ramë) Rama, Svircë.

Këta njerëz të cekur më lart e me siguri edhe të tjerë të cilët unë nuk kam patur mundësi t’i shoh e t’i njoh, veshjen kombëtare në komunën e Medvegjës e mbajtën të fundit. Tani do flasim më konkretisht për veshjen kombëtare të burrave shqiptarë të Medvegjës. Këtë veshje, për ta paraqitur sa më mirë, ndoshta mund t’a ndajmë në disa lloje, siç edhe ishte ashtu realisht:

1. Veshja e fëmijëve meshkuj;
2. Veshja e djemëve të rinj shqiptarë;

3. Veshja e burrave;
4. Veshja e të moshuarëve, apo pleqëve
5. Veshja e të varfërve dhe e të pasurve.

1. VESHJA E FËMIJËVE MESHKUJ

Veshja e fëmijëve sipas gjinisë në këto treva shqiptare fillonte të dallohej që nga mosha e dhjetë e jetës e tutje. Deri atëherë edhe gocat edhe çunat, apo djemtë siç i quajmë ne në këto anë, bartnin të njejtën veshje të cilën e përbënte një të themi këmishë, e që quhej xhup, i qepur tek pjesa më e madhe nga pëlhura e konopit tek të varfërit e nga pëlhura e leshit të deles tek shtresat më të pasura. Pas moshës së dhjetë gocat visheshin me dimia të punuara nga leshi i deleve, kurse djemtë fillonin të bartnin dikurë tierqit e mëpastaj pantallona të zhgunit, të punuar në vek nga nanat e gocat shqiptare.

2. VESHJA E DJEMËVE TË RINJ SHQIPTARË

Mbase veshjen e djemëve nga mosha e dhjetë e jetës e deri sa martoheshin e përbënin:

1. Opingat;
2. Çorapet;
3. Tierqit;
4. Shoka;
5. Këmisha e bardhë;
6. Jeleku;
7. Xhemperi;
8. Plisi i bardhë;
9. Mahrama e bardhë.

- **Opingat** punoheshin nga lëkura e lopës, të cilën zakonisht e therrnin në fillim të stinës së dimrit. Mishin e përdornim për ushqim, zakonisht e ternin(thanin) e pastaj e zienin me fasule, me lakra apo me patate gjatë stinës së dimrit.
- **Çorapet** punoheshin me kërrabëza nga tjerri i bërë prej leshit të deleve ose të dhive, kurse familjet që nuk kishin këto i bënin çorapet edhe nga konopi, i cili kultivohej për ta zavendësuar leshin. Çorapat e djemëve kishin zakonisht ngjyrë të bardhë, por shpesh ishin edhe të larme duke përdorur zakonisht ngjyrën e kuqe dhe ate të zezën, gjithnjë duke i kombinuar me ngjyrën e bardhë, si ngjyrë dominuese.
- **Tierqit**, ishin të punuar nga zhguni i punuar prej leshit të deleve, Zhguni punohej në vek, shkilej në valavicë, pastaj dërgohej tek terziu për t'u qepur dhe kështu bëheshin tierqit.
- **Shoka** ka qenë një pjesë e veshjes që mbështillej rreth brezi. Punohej nga leshi i deles, në vek, me shumë ngjyra, apo më mirë me thënë me të gjitha ngjyrat ekzistuese.
- **Këmisha** kishte ngjyrë të bardhë, ishte e punuar nga pëlhura e pambukut, e ata që nuk kishin pambuk e punonin pëlhurën nga konopi.
- **Jeleku** punohej me kërrabëza nga leshi i deleve.
- **Xhemperi** pokështu punohej me kërrabëza nga leshi i deleve. Xhemperët e djemëve kishin zakonisht ngjyrë të bardhë, por shpesh ishin edhe të larëm duke përdorur zakonisht ngjyrën e kuqe dhe ate të zezën, gjithnjë duke i kombinuar me ngjyrën e bardhë, si ngjyrë dominuese.

- **Plisi i bardhë** është pjesë e veshjes kombëtare me domethënje simbolike për shqiptarët e Medvegjës, prandaj këtë e kanë patur obligim t'a bartin të gjithë që nga fëmiu i cili posa kishte filluar të flaste e të hecete e deri tek i rrituri i cili qoftë edhe i shtrirë në shtrat, nuk ka ndenjur pa plisin në kokë.
- **Mahrama**, ka qenë pjesë e veshjes kombëtare edhe për djemtë, sidomos në të pesëmbëdhjetat e tutje. Bëhej në vek nga fijet e pambukut të cilin e blenin në treg. Kishte gjithmonë ngjyrë të bardhë.

3. VESHJA E BURRAVE

Veshja e burrave shqiptarë të Medvegjës është veshje të cilën e karakterizojn tierqit me ngjyrë galana apo si do i thonim ngjyrë e murrme me gajtana të zi. Veshjen e burrave e përbënin:

1. Opingat;
2. Çorapet;
3. Mestet;
4. Kallqinët;
5. Tierqit;
6. Danet;
7. Shoka;
8. Këmisha;
9. Jeleku;
10. Gjurdia;
11. Plisi;
12. Shalla;
13. Mahrama.

1. **Opingat** punoheshin nga lëkura e lopës dhe tojat e konopit. Punoheshnin në të njejtën mënyrë për të gjitha grupmoshat e meshkujve por edhe të femrave.
2. **Çorapet**, janë pjesë e veshjes të cilat punoheshin nga leshi i deleve dhe për burrat kishin ngjyrë të bardhë apo të larme me disa ngjyra, zakonisht të bardhë, të kuqe dhe të zezë. Barteshin në të gjitha stinët e vitit. Të verës ishin më të holla e të dimrit më të trasha.
3. **Mestet**, janë pjesë e veshjes që punoheshin nga leshi i deleve por jo të gjata sa çorapet. Ato ishin deri tek zogu i këmbës. Barteshin në stinën e dimrit për të mbrojtur këmbën sa më mirë nga të ftohtit.
4. **Kallqinët**, pokështu janë pjesë e veshjes dhe punoheshin nga leshi i deleve, zakonisht me ngjyra të kombinuara. Barteshin në stinën e dimrit për të mbrojtur këmbët nga të ftohtit e madh që mbretëronte në këto treva.
5. **Tierqit**, janë pjesë e veshjes e punuar nga zhguni i cili bëhej prej leshit të deleve. Tierqit e Medvegjes kishin ngjyrë të murrme apo siç i quanin tek ne, tierq galana. Tierqit punoheshin për të gjitha grupmoshat në mënyrë të njejtë.
6. **Danet**, ishin pjesë e veshjes, e punuar nga pëlhura e pambukut, për ata që ishin në gjendje më të mirë ekonomike, ndërsa për ata me gjendje më të ligë ekonomike punoheshin edhe nga pëlhura e konopit. Visheshin nën tierq gjatë dimrit, kurse gjatë verës kur bënte vapë e madhe, burrat i hiqnin tierqit e punonin të veshur në këmishë e në dane, gjithmonë duke e lidhur shokën për brezi.

7. **Shoka**, si pjesë e veshjes kombëtare ishte e pazavendësueshme sepse shërbente për shtërngimin e brezit gjatë punës së rëndë fitike, por edhe për nevoja të tjera.
Punohej prej leshit të deles, në vek, me shumë ngjyra, ku dominonin ngjyra e kuqe, e bardha, e zeza, e verdha e tj. Kishte një gjatësi 4-6 metra.
8. **Këmisha**, mbahej gjithmonë e veshur, në çdo stinë të vitit dhe ishte e ndaluar me dalë jashta dhomës së fjetjes, ishte marre me e pa dikush burrin pa këmishë. Ajo punohej në vek nga fijet e pambukut apo blihej pëlhura e gatshme, varësisht nga mundësitë ekonomike. Këmisha punohej edhe nga pëlhura e konopit për ata që nuk kishin mundësi të blenin fijet apo pëlhurën e pambukut.
9. **Jeleku**, punohej nga zhguni prej të cilit punoheshin edhe tierqit. Kishte ngjyrë të murrme dhe vishej dimrit e verës.
10. **Xhurdia**, ishte pjesa e veshjes mbi jelek e këmishë e që punohej pokështu nga zhguni i punuar në vek, me ngjyrë sikurse edhe tierqit dhe jeleku.
11. **Plisi**, është pjesa më emblematike e veshjes kombëtare, i cili për fat të mirë bartet edhe sot tek një pjesë e burrave shqiptarë të Medvegjes. Plisi punohet nga leshi i deles dhe nga leshi i deveve. Ai nga leshi i deveve ka kualitet më të mirë dhe kosto më të shtrenjtë, andaj ishin të rrallë ata që e banin këtë plis. Obligim i bartjes së plisit ishte për të gjitha grupmoshat që nga fëmija e deri tek të moshuarit, apo pleqtë.
Ekzistonte një bestitni tek shqiptarët e Medvegjes se nuk bën të dilet jashta derës së shtëpisë pa plisin e bardhë në kokë sepse është haram dhe ai që e bënte ate do t'a gjente ndonjë fatkeqësi apo siç i thonin ata taksiratë.
12. **Shalla**, si pjesë e veshjes kombëtare ishte obligative për burrat dhe për pleqtë (të moshuarit). Punohej nga tjerri i leshit të deleve. Punohej me kërrabëza. Kishte ngjyrë të kuqe të mbyllur, apo siç i thonin bojgjake dhe vihej në fund të plisit duke i mbuluar edhe veshët gjatë stinës së dimrit, kurse gjatë stinës së verës mbahej pakëz mbi veshë.
13. **Mahrma**, është pjesë e veshjes kombëtare, e punuar nga fijet e pambukut, në vek. Ka ekskluzivisht ngjyrë të bardhë dhe bartej e mbështjellur në kokë gjatë stinës së verës.

Tek burrat me gjendje më të fortë ekonomike veshjen kombëtare e zburonte edhe sahati me qystekë të cilët viheshin në qafë dhe lëshoheshin mbi gjoksin e atij që e mbante. Në shokë mbahej edhe arma, revolva tek burrat.

4. Veshja e të moshuarëve, apo e pleqëve

Këtë veshje kombëtare e përbënin:

1. Opingat;
2. Çorapat;
3. Tierqit;
4. Danet;
5. Shoka;
6. Këmisha;
7. Jeleku;
8. Xhurdia;
9. Plisi;
10. Shalla.

1. **Opingat**, janë të punuara nga lëkura e lopës, toja të konopit.
2. **Çorapat**, punoheshin nga leshi i deleve ose i dhive, me ngjyrë të murrme apo të zezë. Punoheshin me kërrabëza.
3. **Tierqit**, Sikurse edhe për të gjitha grupmoshat, punoheshin nga zhguni i prodhuar në vek. Ngjyra është e murrme apo galana siç i themi ne në Medvegjë.
4. **Danet**, punoheshin nga pëlhura e pambukut e prodhuar në shtëpi, në vek, apo nga pëlhura e blerë në treg, për ata me gjendje më të mirë ekonomike, kurse ata me gjendje më të dobët ekonomike punoheshin nga pëlhura e konopit e prodhuar në vek në shtëpi.
5. **Shoka**, ishte e njejtë sikur edhe për burrat.
6. **Këmisha**, pokështu punohej nga pëlhura e pambukut e prodhuar në vek në shtëpi, ose nga pëlhura e blerë në treg. Bëheshin edhe nga pëlhura e prodhuar prej konopit, për familjet e varfëra.
7. **Jelevu**, Punohej nga zhguni galan prej leshit të deleve, apo thurej me kërrabëza, gjithashtu nga tjerri i bërë prej leshit të deleve.
8. **Xhurdia**, Punohej nga zhguni galan i bërë në vek prej leshit të deleve dhe ishte e njejtë sikurse ajo e burrave.
9. **Plisi** i bardhë ishte i njejtë për të gjithë.
10. **Shalla**, punohej me kërrabëza, nga leshi i deleve. Kishte ngjyrë të murrme ose të zezë dhe bartej e mbështjellur në kokë gjithmonë dhe në çdo stinë të vitit.

5. VESHJA E TË PASURVE DHE E TË VARFËRVE

Varësisht se si ishte gjendja ekonomike e familjes, ashtu bëhej edhe veshja e tyre. Në familjet të cilat kishin gjendje ekonomike më të mirë, përbërja e veshjes kombëtare ishte complete nga rrobat që përdoreshin për veshje të ditëprditshme, apo të punës dhe ato që përdoreshin për festa e momente solemne. Në familjet që kishin gjendje më të keqe ekonomike, nuk ishte mundësia të kishin edhe rroba për punë edhe për momente solemne, festa e të tj. por të njejtat i përdornin edhe për punë edhe për festa, bile shpesh edhe jo të kompletuara, por gjithmonë të pastra e pedante. Shpesh herë këto rroba edhe harrnoheshin, por nga pedantëria e harrnimit dhe pastërtia e mbajtjes, prap se prap dukeshin të mira. Një gjë ishte karakteristike, edhe në momentet kur nuk ishte mundësia të ishin complete veshjet kombëtare, për arsye të skamjes e varfërisë, plisi i bardhë dhe mahrama, apo shalla, nuk mungonin në asnjë situatë. Besa plisi i bardhë, për fat të mirë, tek disa entuziastë po bartet edhe sot, gjë që nuk qëndron me pjesët e tjera të veshjeve kombëtare. Plisi i bardhë nuk prodhohej në familje, por gjithmonë blehej në treg, sepse teknologjia e punës nuk i përgjigjej prodhimit të tij në kushtet shtëpiake, familiare.

REZYME

Veshja kombëtare edhe tek shqiptarët e Medvgjës, hë për hë, shërben vetëm si një e kaluar e kohës, për ta ruajtur si kujtim apo trashëgimi nga gjeneratat e kaluara dhe për momente të paraqitjes në skena të programeve të ndryshme kulturoartistike. Janë rralluar ata ose ato që dinë ta punojnë këtë veshje dhe ata që e punojnë, mendoj se më tepër janë të motivuar nga aspekti komercial, por shqyr që ka së paku edhe një motiv i tillë e nuk harrohet prodhimi i tyre. Mbase duhet cekur se të gjitha këto veshje kombëtare për të cilat u bë fjalë deri më tani prodhoheshin e punoheshin në familjet shqiptare me duart e vyera të

vajzave, të nanave, të grave, të djemëve e të burrave shqiptarë. Këto punime bëheshin me mjetet më të thjeshta të cilat pokështu i kishin prodhuar vetë siç ishin: kërhanët, boshti, ogërshaku, furka, furka e këmbës, veku e shpata, kërrabëzat, gjilpëra e tj. Qepja e tierqëve, jelekëve dhe xhurdisë bëhej nga mjeshtrit e veçantë që quheshin terëzi, e që ishin të rrallë në rajon. Duhet thënë patjetër se ajo që u tha deri më tani për Veshjen kombëtare të burrave të Medvegjës, si trashëgimi kulturore e kësaj treve, i takon më tepër të kaluarës, sepse në ditët dhe kushtet e sotme ajo veshje është zëvendësuar me të ashtuquajturën “veshjen allafranga” sikur që po ndodhë me të gjitha kombet e tjera.

Por t’i kthehemi temës për të cilën e fillova këtë ekspozitë. Duke u shkëputur plotësisht nga trangu shqiptar, pasi Serbia dhe Turqia e atëhershme vunë kufinj të rinj duke ndarë tokat shqiptare me mexhe të reja, shqiptarët e Medvegjës mbetën nën ingerencat e Serbisë. Siç kishin treguar të vjetrit e këtyre vendeve, e që nuk harrohet kurrë, Serbia lëshoi zullum të madh mbi shqiptarët e këtyre dymbëdhjetë vendbanimeve të mbetura me shqiptarë. Nga njëra anë zullumi vinte prej vet shtetit, nepërmes organeve dhe aparatit të tij, e në anën tjetër edhe nga kolonistët e ardhur serb e malazias, të cilëvevet shteti u kishte lënë “duartë e lira” që të bënin zullum ndaj shqiptarëve. Mirëpo shqiptarët e këtyre trevave, në mënyrën më stoike dhe dinjitoze e burrërore u bënë ballë të gjitha sfidave, zullumeve, vrasjeve e dhunës në vazhdimësi, duke qëndruar në vatrat e veta denbabaden shqiptare. Ata bënin një jetë të vështirë fshatare në të gjitha kohërat dhe në të gjitha regjimet e Serbisë, sepse asnjë ndryshim i pushteteve të Serbisë nuk u sillte gjë të mirë. Jetonin kryesisht në fshatra dhe merreshin me punimin e tokës dhe ruajtjen e bagëtisë. Kishin në pronësi toka të mira të cilat i ushqenin me bukën e gojës. Vendbanimet ishin të tipit të shpërndarë, kodër më kodër, me nga dy tri shtëpi – familje në lagje. Nuk kishte vendbanime të grumbulluara apo të urbanizuara, kështu gjithmonë këtu jeta ishte e vështirësuar. Kryesisht këtu jetohej nga puna e krahut dhe prej viti në vit. Çështja kryesore ishte të sigurohej buka prej të korrave në të korra. Secila familje përveq me bujqësi merrej edhe me blektori dhe me kultivimin e pemëve. Edhe në ditët e sotme janë ruajtur ca sorte të mira të dardhave: dardha bajre, ujce, pikëmiatle apo varoshe, kakiçke, tërhe, gungëqe etj, mollat: vjeshtore, rrypçe, prishtinçe, molla e mixhës Qerim e tj.

Ajo që është më e rëndësishme se këta shqiptarë kishin të zhvilluar edhe shumë artizanale me të cilat merreshin brez pas brezi. Art në vedi ishte punimi i rrobave dhe veshmbathjes. Rrobat punoheshin me krrabëza dhe në vek, zakonisht nga leshi i deleve, pambuku i blerë dhe konopi i cili mbillej në arat e secilës familje. Rrobat punoheshin për të gjithë anëtarët e familjes, pra për fëmijë e të rritur, për burra e për gra. Kësaj here do të shohim se cilat ishin dhe si dukeshin veshjet e burrave shqiptarë në komunën e Medvegjës. Me nocionin burrë në këtë trevë emërohej mashkulli i moshës madhore (nga vitet njëzet e deri në fund të jetës).

Kishte edhe një kategorizim tjetër i mashkujve:

- Djalë,
- Burrë,
- Plak

Me emërtimin djalë nënkuptohej mashkulli në djep e deri në moshën njëzet vjeçare. Me emërtimin burrë nënkuptohej mashkulli i moshës njëzet deri në vitet e gjashtëdhjeta. Me emërtimin plak, nënkuptohej mashkulli i moshës mbi gjashtëdhjetë vjeç. Sipas këtij kategorizimi punoheshin dhe barteshin edhe rrobat.

I.VESHJA E DJEMËVE

Ate e përbënin:

1. Plisi i bardhë i punuar nga leshi i deleve.
2. Shalla e punuar nga leshi i deleve me ngjyrë të bardhë,
3. Këmisha e bardhë, e punuar nga pambuku, por edhe nga konopi, në ato familje me situatë më të brishtë ekonomike,
4. Jeleku i punuar me kërrabëza, nga leshi i deleve, me ngjyrë të bardhë, ose i larëm (me shumë ngjyra),
5. Shoka e larme, e punuar në vek, me shumë ngjyra, ku dominonte ngjyra e kuqe, ngjyra e zezë dhe ngjyra e bardhë,
6. Danet, apo tlinat, nga pëlhura e pambukut e punuar në vek, për ata më të pasur, kurse ato të punuara në vek nga pëlhura e konopit, për ata më të varfër,
7. Tierqit galana, me gajtana të zi,
8. Xhamadani galan, i punuar në vek nga leshi i deleve,
9. Qorapatë e bardha, të punuara me kërrabëza, nga leshi i deleve,
10. Opingat e punuara nga lëkura e lopës.

II. VESHJA E BURRAVE

Veshjen e burrave e përbënin:

1. Plisi i bardhë nga leshi i deles,
2. Plisi i bardhë i punuar nga leshi i deles, për ata më të pasurit,
3. Shalla e punuar nga leshi i deles, me kërrabëza, ngjyrë e kuqe,
4. Mahrama, e punuar në vek, nga pambuku, ekskluzivisht me ngjyrë të bardhë,
5. Këmisha e bardhë nga pëlhura e pambukut e punuar në vek, tek ata më të pasur, kurse ajo e punuar nga pëlhura e konopit, për ata më të varfër.
6. Jeleku i punuar nga leshi i deles, me kërrabëza, ngjyrë të kuqe ose të zezë dhe ai i qepur nga zhguni i punuar në vek nga leshi i deleve,
7. Shoka e larme me shumë ngjyra, e punuar në vek, nga leshi i deleve,
8. Danet ose tlinat, të punuara nga pëlhura e pambukut, për ata me gjendje më të mirë ekonomike, dhe ato të punuara nga pëlhura e konopit, për ata me gjendje më të dobët ekonomike,
9. Tierqit galana, të punuar nga leshi i deleve dhe të dekoruar me gajtana, tek të pasurit me më shumë palë gajtana, e tek të varfërit me më pak gajtana,
10. Xhamadani galan, i punuar nga zhguni i leshit të deleve,
11. Koporani galan i punuar nga zhguni i leshit të deleve,
12. Çorapat e punuara me kërrabëza nga leshi i deles, ngjyrë të bardhë, apo ngjyrë të zezë me ca lara të kuqe e të bardha,
13. Opinga të punuara nga lëkura e lopës, që lidheshin me toja të punuara nga konopi,
14. Këpucët, për ata që ishin me gjendje më të mirë kishin edhe një palë këpucë të blera tek këpucëtari, e që ishin shumë të rrallë.

III. VESHJA E PLEQËVE

Ate e përbënin:

1. Plisi i bardhë i punuar nga leshi i deles,
2. Shalla e zezë, e punuar nga leshi i deles, me kërrabëza,
3. Këmisha e punuar në vek, nga pëlhura e pambukut ose e konopit,
4. Jeleku i punuar me kërrabëza nga leshi i deles, me ngjyrë të zezë, ose galan, apo i punuar edhe nga zhguni i bërë në vek nga leshi i deles,
5. Shoka e punuar në vek nga leshi i deleve, me ngjyrë të kuqe dhe të zezë,
6. Danet nga pëlhura e pambukut pse e konopit, ngjyrë e bardhë, e punuar në vek,
7. Tierqit galana apo të zi, me gajtana, të punuar në vek nga leshi i deles,
8. Xhamadani galan apo i zi, i punuar nga leshi i deleve
9. Çorapatë e punuara me kërrabëza, nga leshi i deles, ngjyrë e zezë,
10. Opingat e punuara nga lëkura e lopës, të lidhura me toja të konopit,



Të gjitha këto prodhime të veshjeve të djemëve, të burrave dhe të pleqëve, punoheshin në shtëpi dhe ekskluzivisht nga dora e gruas dhe vajzës shqiptare. Nuk ka pasur vajzë dhe grua në këto troje që nuk ka ditur dhe nuk ka punuar me kërrabëza dhe në vek. Këtë mjeshtri, apo mund ta quajmë edhe art në vedi, vajzat shqiptare fillonin ta mësonin që nga mosha e re dhe e punonin gjatë tërë jetës. Nuk ka patur grua shqiptare që nuk ka ditur të tjerë leshin e deles, të thurë me kërrabëza dhe të punoj në vek, sepse kjo ishte e vetmja që e siguronte veshëmbathjen edhe për vedi edhe për fëmijë edhe për burrin. Burrat merreshin me qepjen e tierqëve dhe të xhamadanave dhe në këto anë quheshin terëzinj. Nuk ka pasur shumë në këtë rajon, sepse nuk kishte shumë

banorë, por gjithmonë kjo zeje trashëgohej nga brezi në brez familiarisht. Përveç veshjes burri shqiptar i trevës së Medvegjes, kuptohet, kjo varej nga gjendja e tij ekonomike, mbante edhe orë xhepi, të varur në qafë me qystekë karakteristike të argjentit, por kjo ishte më e rrallë. Ishte edhe një veti karakteristike tek burrat që të mbanin armë, në rastet më të shpeshta revole, apo siç e quanin në këto anë allti, e disa edhe pushkë të gjata, në të kaluarën martina, e në kohët më të reja pushkë e tipit mauzer, por edhe pushkë gjuetije. Këto armë e kompletin nocionin e burrit dhe kryesisht përdorëshin në dasma e gëzime.

Për krejt këtë që e thamë deri më tani, mund të thuhet se i takon të kaluarës historike të kësaj treve, sepse fatkeqësisht, këto rroba dhe këto veshje tani më nuk i mbanë askush, përveq ndonjë grup apo shoqëri kulturo-artistike me rastin e ndonjë programi apo feste. Plisin e bardhë e bartin një numër i vogël entuziastësh e që mund të numërohen në gishtërinjtë e një dore, kurse për tierqit, shokën e të tjera as që bëhet më fjalë. Tani më në këto treva nuk ruhen delet, nuk ka grua që e përpunon leshin e deles. Të punojnë me kërrabëza janë të rralla gratë e reja, e mendoj se nuk ka vajzë që i merr kërrabzat në dorë. Një pjesë e madhe nuk e dinë se çka është veku, i cili ishte një makinë e pazavendësueshme për familjen shqiptare. Nuk kishte shtëpi që nuk e kishte ate. Të gjithë meshkujt dinin ta punonin vekun nga druri, e të gjitha gratë dinin të punonin prodhimet e përsosura në vek e me kërrabëza. Por sot kjo më nuk ekziston. Veshja shqiptare tani më është e konfeksionit, e amerikanëve, e italianëve, e kinezëve, e kujt jo tjetër, është bërë veshje internacionale. Mbase, sikur edhe tek të gjithë popujt tjerë të Evropës dhe të botës nuk ka më veshje nacionale apo kombëtare, nuk ka më artizanate dhe prodhime shtëpiake që punoheshin me duartë e vajzave, motrave dhe nënave tona. Çdo familje shqiptare e komunës së Medvegjes, por jo vetëm

ato shiptare, ruanin bagëti, sidomos dele. Ka patur më së paku pesë e dreri më njëqind krerë dele për familje. Nuk kishte familje që nuk ruante asnjë krerë deleje.

SI PËRPUNOHEJ LSHI I DELEVE

Delet qetheshin në fillimin e muajit maj, zakonisht pas ditës së Shëngjergjit (6 maj), atëherë kur fillonte të nxehej koha. Leshi i deles, i cili ishte me ngjyrë natyrore: i bardhë, i zi dhe i murrëm, lahej, shprishej dhe lënuarej. Sasitë më të vogla lënureshin në shtëpi me veglat e thjeshta të quajtura KËRHANË, kurse në sasira më të mëdhaja lënuarja e leshit bëhej në një lloj mini fabrike që quhej LËNURËSE. Këso lloj makine nuk ka patur në pronësi të shqiptarëve, pas dëbimit të shiptarëve nga Sanxhaku i Nishit në vitet 1877/78. Pasi që bëhej lënuarja e leshit, në shtëpitë shqiptare bëhej tjerrja e tij sipas destinimit për çfar nevoje dedikohej, dmtn.çfar dëshirohej të punohej nga ai.

TJERRJA E LSHIT TË DELEVE

Tjerrja e leshit të deleve bëhej me këto vegla: me bosht, me furkë dhe me ogërshak. Këtë punë e kryenin femrat shqiptare. Boshti ishte një vegël e punuar nga druri. Ate e punonin vet në shtëpi, por kishte edhe mjeshtër të specializuar për këtë lloj vegle të vogël. Furka pokështu ishte një vegël e vogël e punuar nga druri që punohej nga meshkujt e shtëpisë. Kishte dy forma: e rrafshët dhe gaforre. Ogërshaku ishte një pjesë e gurit apo më së shumëti e çeremides, e rrumbullakët e shpuar në mes e që vehej në pjesën e poshtme të boshtit për tu rrotulluar ai më mirë dhe më stabil. Gjërat më të thjeshta: çorapat, shallat, xhemperat, jelekët, etj.punoheshin menjëherë pasi që tirej leshi. Gjërat e tjera që kërkonin punë më të ndërlikuar dhe proces tjetër të punës punoheshin në mjetet e thjeshta por shumë praktike. Pjesa më e madhe e punimeve/prodhimeve bëheshin në VEK.

VEKU

Ishte një mjet i punuar në shtëpi. Bëhej nga druri, lloji i drurit nuk ishte me rëndësi, varej se çfar kishte në disponim. Veku kishte këto pjesë:

- Bollëzat,
- Shulat,
- Burdilat,
- Dërrasat e vekut,
- Nërskamcat,
- Shpatën,
- Drukëzën,
- Fydëzat.

Në vek punoheshin të gjitha llojet e pëlhurërave dhe zhëguni. Që të punohej diçka në vek duhej bërë kjo ecuri apo procedurë që ishte goxha e komplikuar dhe e dinin vetëm femrat me eksperiencë të duhur:

1. Endja,
2. Mbulimi
3. Vendosja në shula,
4. Vendosja në liqë,
5. Vendosja në shpatë.

Pas këtyre operacioneve punuese mund të fillohej punimi i asaj që dëshirohej. Po cekim se në vek punoheshin pëlhurat nga leshi i deleve, nga konopi dhe nga pambuku. Në veçanti punoheshin edhe të ashtuquajturit dyshekët për mbulojë e shtroj shtrati, mahramat të cilat i mbanin djemtë e burrat, por edhe vajzat shqiptare. Punimet më karakteristike të bëra nga veku shqiptar ishin çylymat, të zbukuruar me lloj lloj dizajnesh e modelesh të cilat ruheshin e përcilleshin prej familjeje në familje, prej brezi në brez, e që këto punime janë ruajtur edhe deri në ditët e sotme në disa familje entuziaste shqiptare. Pra puna kryesore, apo elementare për të punuar veshmbathjen dhe gjërat e tjera për nevojat jetësore në familjet shqiptare bëhej me mjetet më të thjeshta të punuara nga dora e tyre e që ishin: furka, kërrabëzat dhe veku. Gjilpëra ishte mjete me të cilën më tutje punoheshin prodhimet dhe mirëmbaheshin me te.

MJESHTRIA E VEÇANTË-PUNIMI I TIERQËVE

Nga leshi i deleve bëhej pëlhura e quajtur ZHGUNI. Zhguni punohej nga leshi i deleve. Mund të kishte ngjyrë të zezë, të bardhë, apo galanë. Më së shumeti janë punuar zhgunat me ngjyrë galanë. Pasi që bëhej pëlhura në vek, atëherë duhej dërguar në përpunim të mëtejshëm për t'u "SHKELUR". Shkelja e zhgunave bëhej në një lloj mini fabrike të quajtur "VALAVICË", një lloj makine që punonte me ujë, e përbërë nga një çark me çekiq që e rrahnin pëlhurën e leshit deri sa bëhej e trashë dhe shumë e qëndrueshme. Nga kjo pëlhurë e quajtrë zhgunë pastaj punoheshin tierqitë dhe xhamadant, si veshja më karakteristike shqiptare e këtyre trojeve. Mjeshtritë që i punonin tierqitë dhe xhamadanat quheshin terëzi dhe nuk ishin të shumtë në këtë rajon, sepse edhe nuk ishte mjeshtri e lehtë kjo.



PERFUNDIME

Në tërë këtë punim u bë fjalë për një periudhë kohore e cila i takon të kaluarës historike të një treve të banuar në vazhdimësi me shqiptarë. Por, edhe pse kjo trevë edhe tani banohet me shqiptarë, për gjërat për të cilat folëm deri më tani, nuk mund të thuhet se i kemi edhe sot. Fatkeqësisht, apo fatmirësisht nuk dijmë se cilën ta them, por veshja për të cilën u fol deri më tani dhe puna që bëhej dikur, nuk ekziston më, apo fare pak, pjesërisht. Tani më shumë rrallë, vetëm femrat e moshuara dinë të lëturin leshin e deleve, ta tjerin ate, e të rralla janë ato që dinë të bëjnë punë në vek apo me kërrabëza. Ndoshta do ishte mirë që të shpëtohet kjo lloj zejtarie, e cila dikurë ishte më se e nevojshme për jetën e njerëzve, por në ditët e sotme është shumë interesante, sepse prodhimet e veshëmbathjeve në mënyrë manuale me veglat dhe mjetet më të thjeshta për kohën e sotme janë edhe atraksione. Sidomos është e veçantë veshja e femres shqiptare të Medvegjës, e cila nuk gjendet në trevat e tjera shqiptare, e për të cilën kam shkruar para ca vitesh.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA